


Institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jo-bankare në Kosovë


Në Kosovë, krahas bankave komerciale, shërbime të ngjashme bankare sikurse dhënie të kredive, ofrojnë edhe Ndërmjetësit Tjerë Financiarë (NTF), përfshirë këtu Institucionet Mikrofinanciare (IMF) dhe Institucionet Financiare Jo-Bankare (IFJB). Këto institucione janë bërë pjesë e rëndësishme e sistemit financiar të vendit. Ato janë të specializuara kryesisht në dhënien e kredive për bizneset e vogla dhe të mesme, si dhe për individët me të hyra të ulëta.

- Institucione Mikrofinanciare
- Institucione Financiare Jo-Bankare



Në sektorin financiar të Kosovës, aktualisht operojnë **9 Institucione Mikrofinanciare** aktive që ofrojnë shërbime kreditimi për bizneset e vogla dhe individët. Krahas tyre, ekzistojnë **23 Institucione Financiare Jo-Bankare**, pa përfshirë zyrat e këmbimit valuator, të cilat janë të licencuara ose për të ofruar kredi apo për të kryer shërbime tjera financiare. Këto NTF luajnë një rol të rëndësishëm në diversifikimin e tregut financiar, duke plotësuar hapësirën mes bankave komerciale dhe institucioneve tjera financiare.


Stoku dhe numri i kredive aktive nga NTF-të përgjatë viteve



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës (BQK)

Në periudhën 2015-2024, sektori i Institucioneve Mikrofinancare (IMF) dhe Institucioneve Financiare Jo-Bankare (IFJB) në Kosovë ka përjetuar një rritje të konsiderueshme. Numri i kredive u rrit nga 33,744 në vitin 2015 në 155,525 kredi në vitin 2024. Paralelisht, gjithsej stoku i kredive aktive u rrit nga 82 milionë euro sa ishte në vitin 2015, në 449 milionë euro në fund të vitit 2024. Ky trend i rritjes së vlerës së kredive dëshmon që qytetarët po i shohin këto institucione si një burim mbështetjeje për financimin e nevojave të tyre.


Vlera mesatare për kredi



Vlera mesatare e kredive të lëshuara nga IMF dhe IFJB në Kosovë ka pësuar luhatje përgjatë viteve. Duke filluar nga viti 2015 me një mesatare prej 2,442 euro, trendi ka qenë rritës deri në vitin 2017 ku vlera mesatare e kredive arriti në 2,967 euro. Pas kësaj periudhe, vlera pësoi rënie të ndjeshme, duke arritur pikën më të ulët në vitin 2019 me 1,297 euro, për tu rimëkëmbur përsëri viteve vijuese.

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës (BQK)

Pjesëmarrja e kredive të lëshuara nga NTF në total stokun e kredive



Pjesëmarrja e kredive të IMF dhe IFJB në Kosovë në gjithsej kreditë e lëshuara në sektorin financiar ka treguar një trend të përgjithshëm rritës gjatë periudhës 2015-2024. Duke filluar nga 3.9% në vitin 2015, kjo pjesëmarrje arriti pikën më të lartë në vitin 2024 me 7.2%.

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës (BQK)

Fitimi neto i NTF-ve dhe norma efektive e interesit

■ Fitimi neto ● Norma efektive e interesit ● Kreditë joperformuese




Burimi: Banka Qendrore e Kosovës (BQK)

Norma mesatare efektive e interesit në kreditë e dhëna nga këto institucione mbetet e lartë, në mbi 19%, e cila nuk ka pësuar ndryshime të mëdha ndër vite. Norma të ngajshme të interesit vërehen edhe tek institucionet mikrofinanciare në rajon. Me rritjen e numrit të kredive, është rritur ndjeshëm edhe fitimi neto i këtyre institucioneve në Kosovë, me rreth 20 milionë euro fitim neto të sektorit në vitin 2024. Në anën tjetër, kreditë jo-performuese (KJP) kanë mbetur në nivel tejet të ulët.

Kur një IFJB ofron lizing, ai mundëson që kredimarrësit të përdorin një aset të caktuar (si p.sh. makinë apo makineri) për një periudhë të caktuar kohore, duke paguar një shumë periodike sipas kontratës. Gjatë kësaj periudhe, kredimarrësit kanë vetëm të drejtën e përdorimit të pasurisë, ndërsa pronësia mbetet te institucioni financiar deri në përfundimin e kontratës, moment ky që i mundëson kredimarrësve ta blejnë apo ta kthejnë pasurinë.


Vlera e lizingut të lëshuar nga IFJB-të në Kosovë



Vlera e lizingut të lëshuar nga IFJB-të në Kosovë ka pasur rritje të vazhdueshme përgjatë viteve 2015-2024. Nga viti 2015 deri në 2024, vlera e lizingut është rritur nga 22 milionë euro në 103 milionë euro, që paraqet një rritje prej rreth 372%.

Numri i degëve të NTF përgjatë viteve dhe numri mesatar i kredive të lëshuara për degë


■ Numri i degëve —●— Numri i kredive për degë



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës (BQK)

Numri i degëve të Ndërmjetësve Tjerë Financiar (NTF) në Kosovë ka pasur një rritje të konsiderueshme, duke filluar nga 111 degë sa ishin në vitin 2015 dhe duke arritur në 346 degë në vitin 2024. Në aspektin e kredive për degë, trendi ka qenë më i luhatshëm.

Numri i të punësuarve në NTF përgjatë viteve



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës (BQK)

Numri i të punësuarve në NTF në Kosovë ka shënuar një rritje të konsiderueshme nga viti 2015 deri në vitin 2024. Duke filluar me 814 të punësuar në vitin 2015, sektori ka përjetuar një rritje graduale vit pas viti, duke arritur në 1,639 të punësuar në vitin 2024.

Ndërmjetësit Tjerë Financiar (NTF) aktiv në Kosovë të cilët ofrojnë shërbime kreditimi

IFJB të cilat ofrojnë kredi dhe lizing	Institucionet mikrofinanciare
1. FactorLeasing L.L.C.	1. KEP trust Kosovo Enterprise Program
2. Lesna J.S.C	2. Agency for Finance in Kosovo
3. Raiffeisen Leasing Kosovo LLC	3. FINCA
4. Deutsche Investment Fund – DIF	4. Gramen Trust – KGMAMF
5. TimilInvest J.S.C	5. KosInvest World Vision
6. BI Credit J.S.C	6. Kreditimi Rural i Kosovës
7. Post of Kosovo J.S.C.	7. Start
8. Moneta L.L.C.	8. Qelim Kosova
9. Capital L.L.C	9. Atlantic Capital Partners ACP
10. Unioni Financiar i Prishtinës L.L.C.	10. Iute Credit J.S.C - Në likuidim
11. Vllesa – CO L.L.C.	
12. Leasing Solution L.L.C.	
13. Monego L.L.C. - Në likuidim	
14. Leasing Alberti L.L.C.	
15. Virtus Lending L.L.C.	
16. Pro Finance Home	
17. IBAS	
18. Paysera Kosova L.L.C.	
19. FINSER L.L.C.	
20. Swinto J.S.C.	
21. ZVILO Factor L.L.C.	
22. OneFor Kosovo L.L.C.	
23. NOA SH.A.	
24. Cash Plus SH.A	